

SALI KADRIA

**ASPEKTE TË QËNDRIMIT TË MBAJTUR NGA SHQIPTARËT
GJATË LUFTËS SË PARË BALLKANIKE**

Në mesin e muajit mars 1912, kur shteti osman ndodhej ende në luftë me Italinë, midis Serbisë dhe Bullgarisë u nënshkrua një aleancë politike-ushtarake, së cilës iu bashkuan më vonë, Mali i Zi dhe Greqia të nxitura nga Rusia. Qëllimi i “Lidhjes ballkanike” ishte ndarja midis shteteve ballkanike e zotërimeve të Perandorisë Osmane në Evropë¹. Aleanca ballkanike u paraqit si një masë mbrojtëse ndaj ndonjë sulmi të jashtëm. Bisedimet e fshehta ndërmjet drejtuesve të shtabeve ushtarake të këtyre shteteve, si dhe planet e koordinuara të tyre, dëshmuuan se qëllimi i vërtetë i aleancës ishte sulmi kundër Perandorisë Osmane.

Faktorët që çuan në fillimin e Luftës së Parë Ballkanike

Faktori kryesor që ndikoi në përshpejtimin e veprimeve, për krijimin e një aleance të përbashkët politike e ushtarake ballkanike, ishin koncesionet që iu dhanë shqiptarëve pas kryengritjes së gushtit 1912 dhe frika se vilajetet me shumicë shqiptare, mund të bashkoheshin në një shtet autonom shqiptar². Drejtuesit e shteteve ballkanike pretendonin se me këto lëshime të Portës së Lartë, shqiptarët myslimanë fitonin më shumë të drejta se popullsia e krishterë e Perandorisë Osmane. Emërimin e zyrtarëve shqiptarë në krye të vilajeteve të Janinës dhe Manastirit, ata e konsideruan si një goditje të rëndë për helenizmin dhe sllavizmin. Qeveria greke u frikësua, se greqizimi i mëtejshëm i vilajetit të Janinës mund të dështonte, për shkak të rritjes së ndikimit shqiptar. Greqia

¹ Arben Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha (1912-1914)*, Tiranë: 8 Nëntori, 1978, f. 74-75; Peter Bartl, *Shqiptarët - Nga Mesjeta deri në ditët tona*, përkthyer nga Afrim Koçi, Tiranë: ID&K, 2008, f. 143.

² *Haus - Hof und Staats Archiv, Wien Politisches Archiv Albanien* (më tej: *HHStA.PA.A.*) në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), Vj. 22-21-2183. Telegram i ambasadorit austro-hungarez Pallavicini, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, Jenikoj, 2 tetor 1912.

rrezikonte ta humbiste përgjithmonë “Epirin”, në rast se nuk ndërhynte në këtë moment³.

Gazeta “Dielli” shkruante se “posa u mat Turqia sikur të na japë një hie autonomie, menjëherë fqinjët tanë filluan të lehin dhe të bëhen gati të na sulen”⁴. Shqiptarët përfaqësonin hallkën më të dobët kundrejt fqinjëve, përderisa ata ende nuk kishin formuar shtetin e tyre kombëtar. Drejtuesit e shteteve të konsoliduara fqinje i perceptuan si rrezik, përpjekjet e shqiptarëve për formimin e shtet-kombit të tyre. Teoricieni i nacionalizmit, Ernest Gellner, shkruan se kombet që shpallin pavarësinë më vonë se fqinjët e tyre e vuajnë këtë vonesë. Shkaku është se shtet-kombet që krijohen më herët druhen se krijimi i shteteve të reja bie ndesh me interesat e tyre kombëtare⁵.

Faktor tjetër që nxiti fillimin e Luftës Ballkanike ishte propozimi i ministrit të Jashtëm austro-hungarez, Leopold von Berchtold, i datës 13 gusht 1912, për “decentralizimin e Perandorisë, në përshtatje me raportet etnike”⁶. Propozimi ngjalli dyshimin se Vjena mbështeste shqiptarët në një rajon të dominuar nga interesat sllave. Shqetësimi për propozimin austro-hungarez shprehej qartë në deklaratën e ministrit të Punëve të Jashtme të Rusisë. Sazanov deklaroi se “të trajtosh katër vilajetet osmane si vilajete të mirëfillta shqiptare, do të thoshte të ngrije në këmbë Serbinë, Greqinë dhe Bullgarinë”⁷.

Pretendimet më të mëdha aneksioniste ndaj tokave shqiptare i kishte Serbia. Ajo aspironte të merrte vilajetin e Kosovës, pjesën perëndimore të vilajetit të Manastirit dhe të gjithë bregdetin shqiptar nga Shëngjini deri në Durrës. Ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, Jovanović, kishte deklaruar se vija e kufirit jugor të Serbisë fillonte nga

³ *Po aty*, Vj. 22-21-2187. Letër e ministrit të Austro-Hungarisë në Athinë, Braun, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Athinë, 5 tetor 1912.

⁴ “Turqia dhe Shqipëria”, në *Dielli*, Boston, Mass., 26 shtator 1912, f. 1-2.

⁵ Ernest Gellner, *Nacionalizmi*, përkthyer nga Bashkim Shehu, Tiranë: IDK, 1997, f. 49; Antonello Biagini, *Historia e Shqipërisë nga zanafilla deri në ditët tona*, përkthyer nga Shpëtim Çuçka, Tiranë: Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2000, f. 103.

⁶ *HHStA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-32-6234. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, drejtuar disa përfaqësive të saj diplomatike, Vjenë, 15 gusht 1912.

⁷ *Dokumente franceze për Shqipërinë dhe shqiptarët më 1912*, përgatitur për botim nga Muhamet Shatri, Prishtinë: KGT, 2004, dok. 364. Letër konfidenciale e ambasadorit të Francës pranë Portës së Lartë, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës, Therapia, 3 shtator 1912, f. 257-258.

Prilepi në lindje, kalonte në skajin verior të liqenit të Ohrit dhe arrinte në Durrës⁸.

Greqia synonte të merrte të gjithë viset e Shqipërisë së Jugut deri në lumin Shkumbin, ose të paktën territorin poshtë vijës që niste nga Himara apo Vlora deri në Maqedoni⁹. Objektivi i Malit të Zi ishte aneksimi i viseve veriperëndimore shqiptare, kryesisht qytetin e Shkodrës, si dhe aspironte të merrte Rrafshin e Dukagjinit deri në Prizren.

Bullgarët synonin të merrnin viset perëndimore të vilajetit të Manastirit nga mali i Sharrit deri në Ohër. Traktati i Miqësisë dhe Aleancës i arritur ndërmjet Bullgarisë dhe Serbisë, kishte një shtojcë sekrete¹⁰. Në tekstin e tij, gjendej një paragraf, i cili parashikonte krijimin e njërive autonome respektive. Sa për territoret midis malit të Sharrit dhe liqenit të Ohrit, thuhej se nëse palët nuk binin dakord, atëherë caktimi i vijës kufitare mes tyre do t'i lihej gjykimit të carit të Ruisë.

Më 8 tetor 1912, Mbreti Nikollë i Malit të Zi i shpalli luftë Perandorisë Osmane. Më 13 tetor të vitit 1912, Serbia, Bullgaria dhe Greqia i dorëzuan Portës së Lartë një notë në formë ultimatum, në të cilën kërkohej që Rumelisë t'i jepej autonomia dhe caktimi i kufijve të bëhej sipas popullsisë së saj etnike. Qeveria osmane e konsideroi këtë veprim si ndërhyrje në punët e saj të brendshme. Për këtë arsye, më 17 tetor, ajo i shpalli luftë Serbisë dhe Bullgarisë¹¹, ndërsa me Greqinë u përpoq të ruante asnjësinë.

Lufta e shteteve ballkanike kundër Perandorisë Osmane nisi si një “luftë e shenjtë” për “dëbimin e turqve” nga Ballkani. Lufta e Parë Ballkanike ishte një luftë ekspansioniste që synonte pushtimin dhe aneksimin e territoreve të popujve të tjerë, kryesisht ato shqiptare. Rusia jo vetëm që kishte miratuar marrëveshjen mes aleatëve ballkanikë, por

⁸ *The National Archives*, London (më tej: *TNA*), Foreign Office (më tej: *FO*) 46911/33672/ 12/ 44. Sir R. Paget për Sir Edward Grey, Beograd, 2 nëntor 1912.

⁹ *TNA*, *FO* 45372/33672/12/44. Sir R. Paget për Sir Edward Grey, Beograd, 27 tetor 1912; *AIH*, Vj. 22-23-2354. Telegram i ministrit austro-hungarez Braun, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Athinë, 8 nëntor 1912.

¹⁰ *Çështja shqiptare në Aktet ndërkombëtare të periudhës së Imperializmit (1867-1912)*, vëll. I, Përmbledhje dokumentesh me një vështrim historie, përgatitur nga prof. Arben Puto, Tiranë: 1984, f. 370-376.

¹¹ Süleyman Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk*, Izmir: Kitabevi, 1944, f. 419.

madje merrte përsipër t'i shpallte luftë Austro-Hungarisë, nëse ajo përpiquej të ndalonte përparimin e Serbisë¹².

Qëndrimi i i Fuqive të Mëdha ndaj Luftës së Parë Ballkanike

Fuqitë e Mëdha u kërkuan shteteve të Ballkanit të tregonin maturi dhe deklaruan se nuk do të lejonin ndryshimin e *status quo*-së territoriale në pjesën evropiane të Perandorisë Osmane¹³. Rusia mbajti këtë qëndrim sa për sy e faqe, pasi përpjekjet e shteteve ballkanike kundër Perandorisë Osmane gëzonin mbështetjen e plotë të qeverisë ruse. Ajo synonte që shtetet sllave në Ballkan të ishin një dorë e zgjatur e Ruisë¹⁴.

Qëndrimi i Austro-Hungarisë ndaj Luftës Ballkanike kaloi në dy etapa. Etapa e parë, i përket periudhës nga fillimi i Kryengritjes Shqiptare të vitit 1912 e deri në fund të muajit tetor 1912. Qeveria austro-hungareze iu përmbajt politikës së ruajtjes së status-quo-së së Perandorisë Osmane. Ky qëndrim rezultoi se nuk përputhej me interesat e shtetit austro-hungarez, por as me aspiratat e shqiptarëve. Formula e ruajtjes së *status quo*-së pas fillimit të Luftës Ballkanike ishte hartuar qëllimisht nga Rusia dhe Franca. Ajo do të zbatohet vetëm në rast se ushtria osmane dilte fituese, por jo në rastin e disfatës ushtarake të shteteve ballkanike¹⁵.

Qeveria austro-hungareze u gjend e papërgatitur për zhvillimet e shpejta që ndodhën në Ballkan. Deri më 19 tetor 1912 qeveria austro-hungareze ende nuk kishte përcaktuar qëndrimin e saj lidhur me disa çështje të rëndësishme, si: 1. A do ta lejonte Austro-Hungaria aneksimin e Kosovës nga Serbia?; 2. Çfarë masash do të merrte ajo në rast se Mali i Zi do të zgjerohej në drejtim të Shkodrës, Pejës dhe Gjakovës?; 3. Si

¹² *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-23-2349. Telegram sekret i ambasadorit austro-hungarez Szögyény, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Berlin, 7 nëntor 1912; *po aty*, Vj. 22-23-2351. Telegram i ambasadorit austro-hungarez Thurn, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Berchtold, Beograd, 7 nëntor 1912.

¹³ Raymond Poincaré, *Lufta e Parë dhe e Dytë Ballkanike si dhe Konferenca e Londrës (1912-1913)*, Shkup-Prishtinë-Tiranë: Logos-A, 2009, f. 229; Vasil Kondis, *Greqia dhe Shqipëria 1908-1914*, përkthyer nga Agim I. Tartari, Tiranë: Husi Borshi, 2007, f. 108.

¹⁴ *TNA*, FO 44693/33672/12/44. Sir Ralph Paget për Sir Edward Grey, Beograd, 19 tetor 1912.

¹⁵ Sergej Dmitrievič Sazanov, *Kujtime*, përkthyer nga Vladimir Bregu, Tiranë: Helga's Secrets, 2009, f. 94; S. Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk ...*, f. 422.

mund të shmangej dalja e Serbisë në drejtim të bregdetit shqiptar të Adriatikut?; 4. Deri ku do të lejohej zgjerimi tokësor i Greqisë në drejtim të tokave shqiptare?; 5. Sa do të ishte territori minimal i shtetit të ardhshëm shqiptar që ai të mund të jetonte?; 6. Cila do të ishte mënyra e zgjidhjes së çështjes shqiptare, nëse ata vetë nuk arrinin të krijonin shtetin e tyre kombëtar?¹⁶.

Faktori kryesor që pengoi një veprim energjik të drejtuesve politikë të Vjenës ndaj çështjes shqiptare, ishte mendimi se çdo hap i tepruar diplomatik në drejtim të çështjes ballkanike, do të ngjallte reaksionin e fuqive të tjera dhe mund të komplikonte pozitën e saj¹⁷. Meqenëse drejtuesit e shtetit austro-hungarez nuk arritën të vinin në jetë idenë e autonomisë së shqiptarëve brenda kuadrit të Perandorisë Osmane, ishte e sigurtë se herët ose vonë shtetet ballkanike do t'i shkatërronin objektivat e Vjenës në Ballkan. Megjithëse Austro-Hungaria pati të dhëna se drejtuesit e shtetit serb dhe Rusia po punonin për krijimin e aleancave sllave në Ballkan, ajo nuk arriti të hartonte një platformë të qartë mbi qëndrimin e saj ndaj luftës së tyre kundër Perandorisë Osmane. Gjithashtu, Vjena nuk arriti t'ua bënte të qartë shteteve të Ballkanit se deri ku ishte "vija e kuqe" e shtrirjes së shteteve të Aleancës Ballkanike kundrejt trojeve shqiptare. Kjo mëdyshje e politikës së jashtme të Vjenës, u krijoi shteteve ballkanike terrenin e përshtatshëm që të fillonin luftën kundër Perandorisë Osmane dhe të vinin në zbatim planin e copëtimit të tokave shqiptare.

Etapa e dytë, filloi nga fundi i tetorit 1912 deri në vitin 1913. Kjo periudhë shënoi një kthesë të rëndësishme për politikën austro-hungareze në Ballkan. Gjatë periudhës tetor - nëntor 1912, diplomatët e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë hartuan platformën politike lidhur me çështjen shqiptare. Konferenca e ekspertëve austro-hungarezë për çështjet ballkanike, e mbajtur në Vjenë nga data 16 deri më 19 tetor 1912, arriti në këto përfundime¹⁸. Së pari, formimi i shtetit autonom shqiptar ose

¹⁶ *HHSStA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-21-2193. Protokoll mbi konferencën e mbajtur në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Vjenë, 19 tetor 1912.

¹⁷ *Po aty*, Vj. 22-6-635. Raport i atasheut ushtarak austro-hungarez kolonel Pomiankovsky, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Kostandinopojë, 14 janar 1912.

¹⁸ *Po aty*, Vj. 22-23-2306. Protokoll mbi një konferencë të mbajtur në Ministrinë e Punëve të Jashtme, 16 tetor 1912; *po aty*, Vj. 22-23-2308. Protokoll i konferencës së datës 19 tetor 1912.

shpallja e një Shqipërie të pavarur ishte çelësi kryesor që mbronte vijën perëndimore dhe lindore të zonës së influencës austriake në Ballkan; së dyti, përfshirja brenda kufijve të shtetit shqiptar e viseve që ishin qartësisht shqiptare, do të plotësonte më mirë interesat e Austro-Hungarisë; së treti, mbrojtja e viseve bregdetare shqiptare ishte për të, objektiv më i rëndësishëm krahasuar me vijën lindore nga Pazari i Ri – Kosovë. Ekspertët pranuan se shtrirja maksimale e shtetit shqiptar drejt lindjes dhe juglindjes nuk mund të realizohej për dy arsye kryesore: 1. Në krahinat periferike të vilajeteve të Kosovës, Manastirit dhe të Janinës, përbërja etnike e popullsisë ishte e përzier; 2. Shtrirja e shtetit shqiptar në këto drejtime ishte e vështirë, për shkak të fitoreve të ushtrive të Aleancës Ballkanike. Diplomatët austro-hungarezë nuk shfaqën interes të veçantë për kufijtë jugorë të shtetit shqiptar. Ata pranonin se Greqisë duhej t'i bëheshin lëshime në drejtim të veriut, deri aty ku flitej gjuha shqipe.

Më 3 nëntor 1912, qeveria austro-hungareze arriti në përfundimin se Perandoria Osmane do të shkatërrohej. Pas ndryshimit të rrethanave në Ballkan, drejtuesit e shteteve të bllokut të Trilidhjes filluan të shkëmbejnë mendime, për masat që duhej të merreshin në këtë rast¹⁹. Nga ky moment, mbështetja e Austro-Hungarisë ndaj shqiptarëve hyri në një fazë kulmore. Ajo doli hapur në mbështetje të idesë së shtetit shqiptar dhe kundërshtoi synimet aneksioniste të aleatëve ballkanikë në drejtim të bregdetit shqiptar. “Rreziku i ekspansionit” serb dhe rus gjatë Luftës së Parë Ballkanike ishte faktori kryesor që nxiti Austro-Hungarinë të afrohej më shumë me shqiptarët. Drejtuesit austro-hungarezë arritën në përfundimin se në rrethanat e krijuara, mbrojtja e shqiptarëve dhe e territorit të tyre ishte në fakt mbrojtje e interesave austro-hungareze²⁰. Për zbatimin e kësaj platforme, Austro-Hungaria vendosi fillimisht përdorimin e mjeteve diplomatike. Por, në rast kundërshtimi, ajo kishte në plan të zbatonte edhe masa ekstreme²¹.

¹⁹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F) 591, Dosja (më tej: D.) 2/2, fl. 52. Platforma e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Vjenës për çështjen shqiptare, Vjenë, 3 nëntor 1912.

²⁰ HHStA.P.A.A. në AIH, Vj. 22-8-810. Njoftim i nënkonsullit a-h Rudnay, drejtuar Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Durrës, 7 nëntor 1912.

²¹ AIH, A-IV-175, Një vendim sekret i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë mbi interesat vitale e sekondare austriake në Ballkan në kohën e krizës Ballkanike tetor-nëntor 1912, f. 6-7.

Platforma austro-hungareze u pranua fillimisht nga qeveria gjermane dhe më pas nga ajo italiane, më 11 nëntor 1912. Italia nuk ishte e interesuar që Serbia të dilte në Adriatik dhe që Greqia të aneksonte viset jugore shqiptare. Ajo e kishte të qartë se nëse Serbia pushtonte Shqipërinë apo mbante një territor brenda saj, marrëveshjet italo-austriake do të rrëzoheshin, barazpesha midis fuqive do të përmysej si dhe do të prishej paqja në Evropë²². Diplomatët italianë ishin për idenë e një bashkësundimi austro-hungarez e italian në Shqipëri, ose ndarjen e Shqipërisë në sfera interesash midis tyre²³.

Synimi kryesor i Ruisë ishte që ngushticat që zotëronte shteti osman të mos binin në dorën e ndonjë fuqie tjetër. Qëndrimi i Ruisë ndaj shqiptarëve dukej qartë nga fjalët e ministrit të Punëve të Jashtme, Sazonov: “Asnjë popull nuk na intereson më pak nga ai [shqiptarët]”²⁴.

Franca ishte në favor të shteteve ballkanike, por njëkohësisht synonte të mbante të njëjtën gjatësi vale me politikën e jashtme të Britanisë së Madhe. Sekretari i Shtetit i Gjermanisë i kishte pohuar përfaqësuesit të Serbisë në Berlin se nëse Serbia dhe miqtë e saj merrnin mbështetje nga Rusia, atëherë Gjermania do të reshtohet në krah të aleates së saj²⁵.

Ndërkohë, Britania e Madhe pranonte në parim që Shqipëria duhej të shpallej shtet autonom, por ajo nuk mbështeste pikëpamjen e Austro-Hungarisë për madhësinë e territorit të shtetit të ardhshëm shqiptar. Pas insistimit të Serbisë për të aneksuar limanin e Durrësit, Edward Grey deklaroi prerë se “ne nuk do të lejojmë që Serbia të na tërheqë pas vetes”. Franca dhe Britania e Madhe nuk ishin të gatshme të hynin në luftë me Fuqitë e Aleancës së Trefishtë, për shkak se Serbia dëshironte aneksimin e Durrësit²⁶. Me këtë strategji, diplomacia e rafinuar austro-hungareze

²² TNA, FO 47407/42842/ 12/ 44. Sir E. Goschen për Sir Edward Grey, Berlin, 7 nëntor 1912.

²³ HHSIA.P.A.A. në AIH, Vj. 22-23-2314. Raport i kontit Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë rreth bisedës me San Giuliano, ministër i Punëve të Jashtme të Italisë, Vjenë, 26 tetor 1912.

²⁴ Po aty, Vj. 22-23-2305. Shkresë private e Szilassy, këshilltar i ambasadës së Austro-Hungarisë në Petrograd, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Petrograd, 12 tetor 1912.

²⁵ TNA, FO 47408/ 42842/ 12 / 44. Sir E. Goschen për Sir Edward Grey, Berlin, 7 nëntor 1912.

²⁶ TNA, FO 48632/ 42842/ 12/ 44. Sir Edward Grey për Sir R. Buchanan, FO, 18 nëntor 1912.

arriti të frenonte deri diku agresivitetin e fqinjëve, mbajti rreth vetes aleatët e saj, bëri më të kujdesshme Britaninë e Madhe dhe Francën si dhe zbuti Rusinë²⁷.

Qëndrimi i shqiptarëve pas shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike

Pozita e shqiptarëve pas fillimit të luftës u bë edhe më e vështirë. Shqiptarët u ndodhën para sfidës së vështirë për të zgjedhur ndërmjet besimit fetar dhe identitetit kombëtar. Tajar Zavalani shprehet se udhëheqësit e nacionalizmit shqiptar kuptuan “gati në minutën e fundit ... se po të mos vepronin menjëherë dhe në mënyrë drastike, Shqipëria do të mbaronte, ndoshta përgjithmonë”²⁸. Humbjen e Perandorisë Osmane, shqiptarët do ta paguanin më tepër se turqit, pasi ekzistenca kombëtare e shqiptarëve ishte vënë në pikëpyetje²⁹.

Përcaktimi i qëndrimit që nacionalistët shqiptarë do të mbanin ndaj Luftës Ballkanike nuk ishte një detyrë e lehtë. Përpara tyre paraqiteshin tri mundësi veprimi: të qëndronin përkrah osmanëve kundër ushtrive ballkanike; t’u bashkoheshin ushtrive “çlirimtare” ballkanase kundër ushtrisë osmane; apo të ruanin asnjansinë e tyre. Një pjesë e shqiptarëve shprehej në favor të bashkëpunimit me ushtrinë osmane dhe nuk dëshironte shkëputjen nga Perandoria Osmane. Sipas tyre, shkëputja prej saj do të shoqërohej me copëtimin e tokave shqiptare nga shtetet ballkanike³⁰. Shumica e nacionalistëve shqiptarë ishin mosbesues ndaj qeverisë osmane, por tek ata mbizotëronte mendimi se kalimi i tyre në anën e aleatëve ballkanikë do të sillte copëtimin e Perandorisë Osmane dhe për rrjedhojë, do të ishte asgjësim për shqiptarët³¹.

Në një miting që mbajti federata “Vatra” më 6 tetor të vitit 1912, shumica e nacionalistëve shqiptarë në SHBA dolën me një qëndrim të përbashkët përkrah Perandorisë Osmane. “Marrëveshja me fqinjët

²⁷ Marenglen Verli, *Shqiptarët në optikën e diplomacisë austro-hungareze (1877-1918)*, Tiranë: KLEAN, 2014, f. 231.

²⁸ Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: Phoenix, 1998, f. 224.

²⁹ “Shqipëria në rrezik”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 61, Sofje, 10 nëntor 1912, f. 2.

³⁰ Mid’hat Frashëri, *Shqiptarë dhe Sllavë*, Tiranë: 1998, f. 75.

³¹ *AIH*, Vj. 22-8-816, Njoftimi ambasadorit austro-hungarez Zvidenek, për kontin Berchthold, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë në Vjenë, Uashington, 9 nëntor 1912.

ballkanikë”, theksonte Faik Konica, “është një punë që s’bëhet, se asnjë s’na do dhe asnjë s’do ta ketë me të drejtë”³². Grupimi nacionalist i përfaqësuar nga Faik Konica, Hasan Prishtina, Nexhip Draga, Salih Gjuka, Isa Boletini e të tjerë argumentonin se “nëse turqit kishin ndërmend që të na fusnin një pash nën dhë, sllavo-grekët dhjetë të tjera më thellë”. Në këto kushte, shumica e shqiptarëve arriti në përfundimin se rreziku më i madh për ta vinte nga fqinjët e tyre se sa nga shteti osman.

Qëndrimi “proturk” u kritikua nga një pjesë e nacionalistëve shqiptarë të Bullgarisë. Ky grupim ishte i mendimit, se shqiptarët duhej të mbështeteshin te Bullgaria, për arsye se ajo nuk kishte pretendime territoriale që preknin në shkallë të gjerë trojet shqiptare³³. Gazeta “Liri e Shqipërisë” që botohej në Sofje, hodhi idenë se shqiptarët duhet të kapnin armët për të mbrojtur trojet shqiptare, të kërkonin autonominë, të ngrinin flamurin shqiptar dhe të kërkonin të drejtat e tyre nga Fuqitë e Mëdha³⁴. Nacionalistët shqiptarë me banim në Rumani kërkonin që shqiptarët të mbështeteshin te Rumania, e cila ishte e interesuar për përfshirjen brenda Shqipërisë të viseve, si Grebeneja e Meçova me shumicë vllehe³⁵. Me kalimin e kohës u pa qartë se aleanca e shqiptarëve me këto dy shtete ishte e pamundur.

Një pjesë tjetër e nacionalistëve parapëlqenin të ndiqnin politikën e “neutralitetit”, pasi shqiptarët nuk kishin mjetet e duhura mbrojtëse dhe rrezikonin ekzistencën e tyre. Dukej qartë se interesat e të dy palëve ndërluftuese binin në kundërshtim me aspiratat e kombit shqiptar. Përfaqësuesi kryesor i këtij qëndrimi ishte Ismail Qemali.

Grupi nacionalist i Degës së “Shoqërisë së Zezë në Kosovë”, me përfaqësues, si Salih Gjuka, Nexhip Draga, Bedri Pejani, Mid’hat Frashëri, Rexhep Mitrovica e të tjerë, në marrëveshje me Hasan Prishtinën e Bajram Currin, organizuan një mbledhje në Shkup, më 14 tetor 1912, ku u vendos se shqiptarët do të merrnin armët, jo për të forcuar sundimin osman në Ballkan, por për të mbrojtur tokën dhe lirinë e Shqipërisë. Ata u shprehën se për katër vilajetet, shqiptarët nuk do të pranonin tjetër, veçse një formë të njëjtë politike. Në mbledhjen e

³² “Turqia dhe Shqipëria”, në *Dielli*, Boston, Mass., 26 shtator 1912, f. 1.

³³ *Dielli*, nr. 159, Boston, Mass., 9 dhjetor 1912, f. 2.

³⁴ “Lufta e Përgjithshme e Sinisit të Ballkanit po afron të kërcasë”, në *Liri e Shqipërisë*, nr. 57, Sofje, 22 Vjesht’ e parë 1912, f. 1.

³⁵ “Aleanca Ballkanike”, në *Dielli*, Boston, Mass., 18 prill 1913, f. 1; Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra” (1912-1920)*, Tiranë: Globus R, 2001, f. 46.

Shkupit u vendos caktimi i një delegacioni me kompetencë të plotë për të hyrë në marrëveshje me krahinat e tjera të Shqipërisë për të shpëtuar atdheun nga rreziku i copëtimit³⁶.

Të parët që u ngritën kundër pushtimit sllav dhe i bënë qëndresë përparimit të trupave serbe dhe malazeze ishin shqiptarët e Kosovës. Më 18 tetor 1912, përgjatë vijës së kufirit Merdar -Bujanoc – Kumanovë, shqiptarët organizuan një rezistencë të fortë ndaj forcave të ushtrisë serbe, por sulmi i artillerisë armike, u shkaktoi humbje të mëdha atyre³⁷. Beteja të ashpra u zhvilluan në krahinën e Lumës nën drejtimin e Isa Boletinit. Malësorët e krahinës së Mirditës nuk u bënë rezistencë trupave serbe, pasi ndoqën këshillën e Preng Bibë Dodës³⁸. Ndërkohë, Ahmet Zogu me forcat e tij doli në mbrojtje të krahinës së Shkodrës dhe të Matit³⁹.

Për më pak se dy muaj, ushtritë serbe dhe malazeze arritën të pushtonin me shpejtësi shumicën e viseve shqiptare. Ushtria osmane u thye në disa prej betejave kryesore, ndërsa në të shumtën e rasteve ushtria serbe dhe ajo malazeze marshoi pa ndeshur ndonjë rezistencë të fortë⁴⁰. Rezistenca e kufizuar e një pjese të forcave shqiptare, nuk arriti të ndryshonte rrjedhën e përgjithshme të operacioneve ushtarake.

Faktorët që ndikuan në reagimin e dobët të forcave kombëtare shqiptare ndaj agresionit të ushtrive të Aleancës Ballkanike

Shtrohet pyetja: Përse në këto momente vendimtare për çështjen kombëtare, në mesin e forcave kombëtare shqiptare dhe të ushtrisë

³⁶ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-14-1408. Raport i konsullit austro-hungarez, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 18 tetor 1912.

³⁷ *Rat na Balkanu 1912-1913*, Zagreb: 1913, f. 44, cituar sipas Tahir Abdyli, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare e Demokratike Shqiptare (1908-1933)*, Prishtinë: GME, 2003, f. 168-169.

³⁸ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-25-2544. Telegram i konsullit austro-hungarez Heimroth, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 27 nëntor 1912; *po aty*, Vj. 22-25-2537. Telegram i konsullit austro-hungarez Heimroth, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkup, 26 nëntor 1912.

³⁹ Kristo Dako, *Shënime historike nga jeta dhe veprat e N. M. T. Zogu I – Mbret' i Shqiptarvet*, Tiranë: Kristo Luarasi, 1937, f. 31-32.

⁴⁰ Borislav Ratkovič, *Prvi Balkanski Rat, 1912-1913*, vol. II, Beograd: 1957, f. 835, 856.

osmane u vu re një lloj hutimi, demoralizmi dhe mungesë organizimi? Faktorët që ndikuan në këtë drejtim janë të shumtë.

Së pari, në mesin e forcave kombëtare shqiptare nuk pati unitet mendimi e veprimi; te shqiptarët mungoi një qendër e përbashkët drejtimi dhe një pjesë e popullsisë shqiptare ra pre e propagandës së qeverive fqinje. Në këtë moment vendimtar, elita nacionaliste shqiptare nuk qe në gjendje t'u ofronte shqiptarëve një organizim unik dhe të përgjithshëm. Për këtë arsye, në mesin e shqiptarëve dominoi mendimi që secili të luftonte për të mbrojtur pragun e shtëpisë së tij. Shqiptarët vepruan sipas rrethanave lokale nën drejtimin e krerëve të krahinave të tyre.

Së dyti, megjithëse qeveria osmane ishte në dijeni të planeve të sulmit të shteteve ballkanike, ajo u tregua e ngathët për organizimin e mbrojtjes. Ndërkohë, ushtritë serbe dhe malazeze ishin urdhëruar që në luftën kundër forcave osmane dhe shqiptarëve të vetëorganizuar, të ndërmerreshin qysh në fillim sulme të njëkohshme e të furishme nga të gjitha anët. Taktika e “stuhisë luftarake” si dhe mungesat në mjete ushtarake, ndikuan që shqiptarët të mos u bënë ballë ushtrive të rregullta të Aleancës Ballkanike, të pajisura me teknikën më moderne ushtarake⁴¹.

Së treti, drejtuesit e qeverisë serbe e dinin se ushtria e tyre do të gjente mbështetje te një pjesë e shqiptarëve, pasi pak kohë më parë, ajo i kishte furnizuar ata me armë⁴². Ndërkohë që ushtria serbe marshonte në drejtim të Prizrenit, pati raste të tilla, si ai i kryetarit dhe këshillit të kazasë së Prizrenit, të cilët u shprehën se “nuk jemi të mendimit të qëndrojmë dhe të djegim e të shkatërrojmë vendin prej armikut. Nuk duam të na vriten gratë e fëmijët. Ushtria [osmane] të dalë sa më parë nga Prizreni”⁴³.

Së katërti, një pjesë e shqiptarëve refuzuan thirrjen për mobilizim në ushtrinë osmane, pasi ata ndiheshin të lodhur nga kryengritjet kundër qeverisë osmane nga viti 1908 deri në vitin 1912. Midis shqiptarëve dhe drejtuesve të shtetit osman kishte humbur besimi reciprok, sepse xhonturqit kishin ushtruar dhunë të egër ndaj shqiptarëve. Ministri britanik në Beograd, Ralph Paget, duke analizuar shkaqet e marshimit të shpejtë të forcave serbe, theksonte se “sikur të kishin bashkëpunuar forcat

⁴¹ T. Abdyl, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare...*, f. 178; Liman Rushiti, “Idriz Seferi dhe paria shqiptare në burgun e Beogradit”, në *Jeta dhe vepra e Idriz Seferit*, botim i Institutit të Historisë së Prishtinës, Prishtinë: 2003, f. 134.

⁴² T. Abdyl, *Hasan Prishtina në Lëvizjen Kombëtare...*, f. 177.

⁴³ S. Külçe, *Osmanlı Tarihinde Arnavutluk ...*, f. 438.

e rregullta turke me shqiptarët, ushtria serbe do të kishte rezultate krejt të tjera”⁴⁴.

Qëndrimi i shqiptarëve katolikë në Luftën e Parë Ballkanike

Shqiptarët katolikë gjendeshin para një situatë të vështirë në qëndrimin që duhej të mbanin ndaj marshimit të ushtrisë malazeze. Nga njëra anë, popullsia katolike shqiptare ishte e vendosur që të mos i nënshtrohej më sundimit osman, por nga ana tjetër, ajo nuk dëshironte as sundimin malazet. Meqenëse Austro-Hungaria nuk doli hapur në mbrojtje të saj, atëherë një pjesë e popullsisë katolike ishte e mendimit se duhej të afrohej me Malin e Zi⁴⁵. Përpyekjet e Monsinjorëve Jak Serreqi dhe Gjergj Koleci për të zbutur qëndrimin e malësorëve ndaj regjimit osman si dhe për t’i tërhequr ata nga bashkëpunimi me Malin e Zi, nuk pati rezultat pozitiv. Kërkesës së qeverisë austro-hungareze që popullsisë katolike të Malësisë së Madhe t’i jepej e drejta e autonomisë që ajo të mos binte në “prehrin” e Malit të Zi, Porta e Lartë iu përgjigj negativisht. Sipas drejtuesve të shtetit osman, ishte e pamundur që një fraksion i popullsisë shqiptare të trajtohej në mënyrë të privilegjuar, krahasuar me pjesën tjetër të kombit shqiptar⁴⁶.

Qeveria austro-hungareze e dënoi bashkëpunimin e malësorëve katolikë me Malin e Zi, pasi “ai ishte në kundërshtim me unitetin, aq të dëshiruar, të të gjithë kombit shqiptar”. Akti i tyre shkonte kundër politikës së ndjekur nga Vjena, e cila synonte të afronte klerin katolik me bujarët myslimanë shqiptarë; të nxiste besimin reciprok midis shqiptarëve

⁴⁴ *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)*, përgatitur nga prof. dr. Muhamet Shatri, botim i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë: Toena, 2012, dok. 48. Sir R. Paget për Sir E. Grey, Beograd, 19 tetor 1912.

⁴⁵ *HHSIA.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-1-155. Relacion i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez Zambaur, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, kontit Berchtold, Shkodër, 14 tetor 1912; *po aty*, Vj. 22-4-482. Raport i konsullit të përgjithshëm austro-hungarez Zambaur, drejtuar kontit Berchtold në Vjenë, Shkodër, 27 tetor 1912.

⁴⁶ *Po aty*, Vj. 22-4-489. Procesverbal i takimit të ambasadorit osman në Vjenë, Mavrojen Beu, me një zyrtar të lartë të pidentifikuar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vjenë, 21 shtator 1912.

të të dy besimeve si dhe të mbante kombin shqiptar në anën e saj⁴⁷. Diplomatat austriakë parashikonin se nëse Mali i Zi dilte fitues në Luftën Ballkanike, ai do të aneksonte një pjesë të tokave të Malësisë, të cilat banoheshin nga shqiptarë katolikë. Ky akt do të kishte dy rrjedhoja negative: *Së pari*, do të shkëpuste një pjesë të konsiderueshme të viseve kompakte katolike të Shqipërisë. *Së dyti*, pjesa tjetër e popullsisë katolike në Mirditë, Zadrimë dhe Shkodër, do të mbetej një pakicë popullsie e parëndësishme brenda shtetit shqiptar, nën dominimin e shumicës së shqiptarëve myslimanë⁴⁸.

Më të prirur për bashkëpunim me Malin e Zi ishin Malësia e Madhe, fiset e Pultit (Dukagjinit) dhe Zadrima, pasi në këto vende, propaganda malazeze për bashkimin me Malin e Zi kishte gjetur një terren më të përshtatshëm⁴⁹. Bashkëpunimi i bajraktarëve të Grudës, Hotit, Kastratit, Shkrelit dhe e një pjese të klerit katolik me Malin e Zi; mosbesimi, vrasja dhe arrestimi i disa shqiptarëve katolikë nga autoritetet osmane, me akuzën se familjarët e tyre ishin bashkuar me kryengritësit si dhe nxitja e popullsisë myslimane të Shkodrës, thelloi urrejtjen e shqiptarëve katolikë ndaj sundimit osman, njëherësh thelloi përçarjen mes shqiptarëve të krishterë e atyre myslimanë⁵⁰.

Afrimi i shqiptarëve katolikë me Malin ishte rrjedhojë e dëshpërimit të disa krerëve shqiptarë katolikë, të cilët mendonin se ata ishin neglizhuar nga Austro-Hungaria. Koncesionet e akorduara shqiptarëve në gusht 1912, nxitën shqiptarët katolikë të mendonin se

⁴⁷ *Po aty*, Vj. 22-4-245. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë për Bilinski-n, konsullin austro-hungarez në Janinë dhe Pallavicini-n, ambasador i Austro-Hungarisë në Perandorinë Osmane, Vjenë, 10 tetor 1912; *po aty*, Vj. 22-15-1570. Informacion konfidencial i konsullit austro-hungarez Rudnay për ambasadorin austro-hungarez në Stamboll, Pallavicinin, Durrës, 12 tetor 1912.

⁴⁸ *Po aty*, Vj. 22-1-155. Informacion i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Shkodër, 14 tetor 1912.

⁴⁹ *Po aty*, Vj. 22-18-1882. Letër e famullitarit të Bajzës, At Lorenc Mitrovica, drejtuar konsullit austro-hungarez në Shkodër, Bajzë-Kastrat, 27 gusht 1912; *po aty*, Vj. 22-76. Raport i konsullit austro-hungarez Zambaur, drejtuar kontit Berchtold në Vjenë, Shkodër, 28 gusht 1912.

⁵⁰ *Po aty*, Vj. 22-1-102. Raport i konsullit austro-hungarez Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Shkodër, 30 gusht 1912.

shteti osman vazhdonte t'i linte pas dore⁵¹. Motiv tjetër, ishte urrejtja që ata kishin ndaj sundimit osman, por edhe një lloj pakënaqësie e mungese besimi ndaj shqiptarëve myslimanë. Një pjesë e tyre, druheshin se nëse do të realizohej autonomia politike e Shqipërisë, “ata do të mundoheshin prej myslimanëve”⁵². Në fund të muajit shtator 1912, bashkëpunëtorët e Malit të Zi i paraqitën MonsinJOR J. Serreqit, argjipeshkvit të Shkodrës, një projekt, i cili parashikonte bashkëpunimin e malësorëve me ushtrinë malazeze; dëbimin e garnizoneve osmane deri në Durrës ose të paktën deri në lumin Drin dhe formimin e një shteti dualist malazezo-shqiptar sipas modelit austro-hungarez⁵³.

Mbreti Nikolla arriti t'i bënte për vete shqiptarët katolikë përmes dy rrugëve: *Së pari*, ai shpërdoroi besimin e malësorëve shqiptarë. Sipas traditës, tek malësorët ishte i pranishëm mendimi se fiset malazeze të Vasojeviçëve, të Kuçit dhe të Piperit, ishin “vllazën” me fiset shqiptare të malësisë, por me kalimin e kohës, ato ishin shkëputur nga njëri-tjetri. Disa prej fiseve mbetën katolike, fise të tjerë u kthyen në besimin mysliman, ndërsa pjesa tjetër që jetonte në Mal të Zi, u konvertua në fenë ortodokse dhe u sllavizuan⁵⁴. *Së dyti*, qeveria malazeze i joshi malësorët përmes dhurimit të armëve e mjeteve të tjera. Nga viti 1911 e deri në fillim të muajit shtator 1912, Mali i Zi u shpërndau rreth dhjetë mijë pushkë malësorëve të Mbishkodrës⁵⁵.

Pas shpalljes së luftës së Malit të Zi kundër shtetit osman, një pjesë e mirë e malësorëve katolikë ndihmuan përparimin e forcave ushtarake të Malit të Zi. Vendimi për nxjerrjen e së dhjetës në krahinën e Zadrimës dhe ftesa që valiu i Shkodrës, Hasan Riza Beu, u bëri prijësve të Kosovës, si Isa Boletini dhe Riza Bej Kryeziu për të luftuar kundër shqiptarëve katolikë, thelloi më tepër përçarjen fetare ndërmjet

⁵¹ *Po aty*, Vj. 22-1-160; Vj. 22-18-1813. Informacion i ambasadorit austro-hungarez Pallavicini, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Kostandinopojë, 24 tetor 1912.

⁵² *Po aty*, Vj. 22-2-250. Raport i ministrit Fuqiptotë austro-hungarez, Ugron, për kontin Berchtold, Beograd, 24 mars 1912.

⁵³ *Po aty*, Vj. 22-1-165. Njoftim i konsullit Zambaur, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 28 shtator 1912.

⁵⁴ Eqrem Çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, Shkodër: Hylli i Dritës, 1939, Serie e re, 1, f. 21.

⁵⁵ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-3-362. Njoftim i ministrit Fuqiptotë austro-hungarez Giesl, për kontin Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Cetinë, 4 shtator 1912.

shqiptarëve si dhe nxiti shqiptarët katolikë të gjenin strehim në shtetin fqinj. Praninë e tyre, Mali i Zi e përdori si pretekst për pushtimin e krahinave shqiptare⁵⁶.

Bashkëpunimi i shqiptarëve katolikë me Malin e Zi nuk duhet parë “en block”. Në mesin e shqiptarëve katolikë pati dy rryma kryesore: *Rryma e parë*, përfaqësohej kryesisht nga drejtues të klerit, si Imzot Jak Serreqi, imzot Bianki dhe Dom Nikollë Kaçorri. Ata ishin të bindur se bashkëpunimi i shqiptarëve me Malin e Zi ishte fatal për fatin e shqiptarëve katolikë. Me nxitjen e Ali Fehmi Beut, kreut provizor të vilajetit të Shkodrës, Dom Nikollë Kaçorri, Monsinjor Bianki, Fadil Pashë Toptani dhe Abdi bej Toptani u përpoqën të arrinin një marrëveshje me banorët e krahinës së Mirditës që shqiptarët të bashkonin forcat e tyre. Ata mendonin se në këtë mënyrë do të sigurohej ekzistenca e kombit shqiptar përballë lakmive të shteteve fqinje⁵⁷. Përfaqësuesit e popullsisë katolike të Mirditës u shprehën se ishin kundër cedimit të trojeve shqiptare në favor të Malit të Zi, megjithatë kjo krahinë mbajti një qëndrim pritës⁵⁸. Pavarësisht përpjekjeve të kësaj rryme, përfaqësuesit e saj nuk arritën që të ndalonin bashkëpunimin e një pjese të shqiptarëve katolikë me Malin e Zi, kjo edhe për shkak të gabimeve të autoriteteve osmane.

Rryma e dytë, përbëhej nga malësorët e Mbishkodrës, një pjesë e banorëve katolikë të qytetit të Shkodrës dhe ndonjë klerik i rangut të ulët. Banorët katolikë që jetonin në anën e djathtë të lumit Buna, ishin të armatosur dhe nën ndikimin e plotë të Malit të Zi⁵⁹. Ndërmjet malësorëve, bajraktari Sokol Baci, shquhej për lidhjen e tij të ngushtë me Malin e Zi. Ai i nxiste shqiptarët katolikë të bashkëpunonin me Malin e

⁵⁶ *Po aty*, Vj. 22-1-161. Njoftim i konsullit austro-hungarez Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Shkodër, 26 shtator 1912.

⁵⁷ *Po aty*, Vj. 22-4-245. Telegram i Ministrisë së Punëve të Jashtme në Vjenë për Bilinski-n, konsullin austro-hungarez në Janinë dhe Pallavicini-n, ambasador i Austro-Hungarisë në Perandorinë Osmane, Vjenë, 10 tetor 1912; *po aty*, Vj. 22-15-1570. Informacion konfidencial i konsullit austro-hungarez Rudnay, për Pallavicinin, ambasador i Austro-Hungarisë në Stamboll, Durrës, 12 tetor 1912.

⁵⁸ *Po aty*, Vj. 22-1-157. Informacion i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Zambaur, për kontin Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Shkodër, 13 tetor 1912.

⁵⁹ *Po aty*, Vj. 22-1-156. Informacion i konsullit të Përgjithshëm austro-hungarez Zambaur, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Shkodër, 15 tetor 1912.

Zi. Lidhur me këtë episod, At Gjergj Fishta kritikoi ashpër atë pjesë të shqiptarëve katolikë, të cilët bashkuan armët me ushtrinë malazeze⁶⁰. Ministria e Punëve të Jashtme austro-hungareze i kërkoi Selisë së Shenjtë të ndërhynte pranë klerit katolik në Shqipëri dhe të ndikonte që shqiptarët katolikë të mos luftonin në anën e Malit të Zi. Mirëpo, përgjigjja e drejtuesve të Vatikanit nuk e kënaqi diplomacinë austriake pasi ata u kapën pas frazës së njohur se kisha nuk përzihej në politikë⁶¹.

Nuk kaloi shumë kohë dhe shqiptarët katolikë ndryshuan qëndrimin e tyre ndaj Malit të Zi. Duke parë krimet e malazezëve ndaj shqiptarëve myslimanë, djegiet e shtëpive dhe shkatërrimin e pronave të tyre, malësorët i kuptuan synimet e malazezëve ndaj tokave të tyre. Ata u ndien të fyer kur malazezët i detyruan që të mbanin kapica [kapele] malazeze. Komandantët malazezë detyronin me forcë parinë dhe myftinjtë e qyteteve të pushtuara të nënshkruanin deklaratë, në të cilat popullsia e viseve të pushtuara “lutej” që të futej nën sundimin malazez. Autoritetet malazeze synonin t’i përdornin këto dokumente, si argument për të justifikuar pretendimet e tyre aneksioniste. Qëllimi i Mbretit Nikollë ndaj shqiptarëve katolikë dukej qartë në deklaratën e tij bërë princ A. Gjiksë se “sot malësorët vepronin si aleatë, por nesër si nënshitetas të ardhshëm” të Malit të Zi⁶².

Pas arritjes së marrëveshjes të qeverisë osmane me shqiptarët e Kosovës, drejtuesi i vilajetit të Shkodrës Hasan Riza Beu, ndryshoi krejtësisht qëndrimin e tij ndaj shqiptarëve katolikë. Kjo ndodhi në një moment të papërshtatshëm. Ai ndoqi një politikë që nisi me armatimin e shqiptarëve myslimanë dhe gjeti më tepër shprehje në vrasjet e disa katolikëve në Barbullush dhe në Hajmel, në fillim të muajit shtator 1912 nga forcat ushtarake osmane. Këto ngjarje penguan mbledhjen e prijësve dhe të peshkopëve katolikë në Shkodër për të shprehur lirshëm kërkesat e tyre. Edhe njoftimin e Ibrahim Pashës për koncesionet e akorduara

⁶⁰ Gjergj Fishta, *Shqiptarët dhe të drejtat e tyre*, përgatitur nga Tonin Çobani, Lezhë: Eb Lisitan, 1998, f. 17.

⁶¹ *HHStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-1-159. Informacion i ambasadorit austro-hungarez Schönburg, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Romë, 22 dhjetor 1912.

⁶² *Po aty*, Vj. 22-23-2316. Raport i ministrit austro-hungarez Giesl, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Cetinë, 28 tetor 1912; *po aty*, Vj. 22-15-1567. Telegram i nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, drejtuar Pallavicini-t në Stamboll, Durrës, 3 nëntor 1912.

shqiptarëve në gusht 1912, autoritetet lokale osmane e vonuan për një kohë të gjatë. Të gjitha këto ngjarje thelluan mosbesimin në radhët e malësorëve dhe nxitën afrimin e tyre me Malin e Zi. Tashmë, krahas popullsisë së krishterë të qytetit të Shkodrës, edhe krahinat e Zadrimës, Mirditës dhe një pjesë e klerit katolik që më parë nuk donin t'ia dinin për Malin e Zi, filluan të lëkundeshin.

Pushtimi i viseve shqiptare nga ushtritë serbe, malazeze dhe greke gjatë Luftës së Parë Ballkanike në vitin 1912, pati pasoja të pariparueshme për kombin shqiptar dhe të ardhmen e shtetit shqiptar. Forcat serbe, malazeze dhe greke kryen vrasje dhe masakra çnjerëzore ndaj popullsisë shqiptare që janë përcaktuar si gjenocid i tmerrshëm⁶³. Diplomatët austro-hungarezë ishin të informuar se qeveria serbe kishte dhënë urdhër për vrasjen e të gjithë shqiptarëve mbi tetë vjeç dhe për ta shuar krejtësisht popullsinë shqiptare⁶⁴. Studiuesi Michael Ignatieff shkruan se nacionalizmi që synon poshtërimin e kombeve të tjera, quhet shovinizëm⁶⁵.

Megjithëse më 3 dhjetor 1912 u shpall armëpushimi midis Perandorisë Osmane dhe Serbisë, Bullgarisë dhe Malit të Zi, rezistenca e shqiptarëve kundër forcave të Aleancës Ballkanike vazhdoi më gjatë, në dy fronte lufte të rëndësishme, në mbrojtjen e Shkodrës nga pushtimi malazez, deri më 23 prill 1913 dhe në mbrojtjen e Janinës nga pushtimi grek deri më 6 mars 1913. Greqia nuk pranoi nënshkrimin e marrëveshjes së armëpushimit të datës 3 dhjetor 1912, sepse synonte zgjerimin e pushtimit të saj ushtarak në "Epir". Më 20 dhjetor 1912, komandanti i divizioneve greke hyri në Korçë. Në fshatrat e banuara me shqiptarë myslimanë të krahinës së Devollit, andartët grekë plaçkitën dhe dogjën shumë shtëpi të tyre. Forcat e ushtrisë greke arrestuan mjaft nacionalistë shqiptarë, vranë mjaft shqiptarë myslimanë, klerikë bektashi si dhe shkatërruan një pjesë të teqeve të krahinave të jugut, sepse ato kishin

⁶³ Leon Trotsky, *The Balkan Wars (1912-1913)*, New York: 1980, f. 267; Anton Pançev, "Pozicioni i VMRO-s kundrejt çështjes shqiptare rreth viteve 1911-1915", në *100 vjet Pavarësi – Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare Tiranë, më 26 - 27 nëntor 2012*, vëll. I, përgatitur për botim nga Akademik Beqir Meta, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2014, f. 338.

⁶⁴ *HHSa.P.A.A.* në *AIH*, Vj. 22-24-2424. Telegram i ministrit austro-hungarez Ugron, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Beograd, 15 nëntor 1912.

⁶⁵ Gerasimos Augustinos, *The National Idea in Eastern Europe: The Politics of Ethnic and Civic Community*, Lexington, Mass: Heath, D. C., 1996, f. 129.

shërbyer si qendra të përhapjes së idesë kombëtare. Gjithashtu, edhe forcat serbe prishën në Kosovë një pjesë të teqeve dhe shumicën e tyre i kthyen në kisha e manastire⁶⁶.

Kalimi nga platforma autonomiste në atë të Pavarësisë së Shqipërisë

Pas thyerjes së ushtrisë osmane, shqiptarët kuptuan se Austro-Hungaria ishte e vetmja shpresë për të shpëtuar nga rreziku i copëtimit dhe i shkombëtarizimit të tyre. Rrethet nacionaliste shqiptare prisnin një ndërhyrje të mundshme të Austro-Hungarisë në favor të një Shqipërie të pavarur⁶⁷. Një grup nacionalistësh shqiptarë i drejtuan një thirrje Fuqive të Mëdha, në të cilën theksohej se ekzistenca e shqiptarëve ishte e rrezikuar, për shkak të pushtimit të shteteve fqinje si dhe ata “druheshin nga pasojat e ndreqjes së hartës së Ballkanit në dëmin e tij”. Ata u kërkuan Fuqive të Mëdha të garantonin të drejtën e ekzistencës për të gjithë kombet e Ballkanit⁶⁸.

Dokumentet dëshmojnë se deri në mesin e nëntorit 1912, asnjë prej nacionalistëve shqiptarë nuk shfaqi pikëpamjen se shqiptarët duhej të shkëputeshin nga Perandoria Osmane. Kalimi nga platforma e autonomisë administrative, në atë të pavarësisë së Shqipërisë ndodhi kur u pa qartë se ushtria osmane u thye në Luftën Ballkanike⁶⁹. Shumica e shqiptarëve të alarmuar nga përparimi i trupave serbe në drejtim të Durrësit, arritën në përfundimin se përkundër pushtimit nga ana e ushtrive ballkanike, zgjidhja më e drejtë ishte shpallja e pavarësisë së Shqipërisë me mbështetjen e Austro-Hungarisë⁷⁰.

⁶⁶ Ali Tomori, *Historija e Bektashinjvet*, Tiranë: Shtypshkronja “Mbrothësija” Kristo P. Luarasi, 1929, f. 89-90.

⁶⁷ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-8-810. Njoftim i nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, Durrës, 7 nëntor 1912.

⁶⁸ *Po aty*, Vj. 22-18-1884. Thirrje e popullit shqiptar drejtuar Fuqive të Mëdha lidhur me mbrojtjen e çështjes shqiptare nga rreziqet e Luftës Ballkanike [Dokumenti është pa datë].

⁶⁹ Stefanaq Pollo, “Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar dhe Shpallja e Pavarësisë më 28 nëntor 1912”, në *Buletin i Universitetit Shtetëror të Tiranës*, Seria Shkenca Shoqërore, nr. 4, Tiranë: 1962, f. 82-83.

⁷⁰ *HHSIA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-8-821. Telegram i nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, drejtuar Budapestit dhe disa përfaqësive diplomatike austro-hungareze, Durrës, 12 nëntor 1912.

Në emër të parisë shqiptare të viseve jugore dhe të mesme, nismën e morën Syrja Bej Vlora dhe i biri i tij Eqrem Bej Vlora. Ky i fundit u nis për në Vjenë për të diskutuar me diplomatët vjenezë për qëndrimin që duhej të mbanin shqiptarët në rrethanat e reja të krijuara pas fillimit të Luftës Ballkanike si dhe për të mësuar për qëndrimin që do të mbante qeveria austriake ndaj çështjes shqiptare në rast se Perandoria Osmane mundej nga shtetet ballkanike⁷¹. Përgjigjja e Vjenës ishte se ajo kishte për qëllim të ruante integritetin e Shqipërisë në jug, së pak deri në lumin Kalama dhe se mbështeste rezistencën kombëtare të shqiptarëve.

Disa prej përfaqësuesve të elitës politike shqiptare në Stamboll dhe në kolonitë e tjera shqiptare jashtë vendit ishin bindur plotësisht se statusi i autonomisë, tashmë nuk mund t'i shpëtonte trojet shqiptare nga rreziku i copëtimit. Fuad Bej Dibra dhe Ali Danish Prishtina ishin të një mendjeje që sa më shpejt që të ishte e mundur, një delegacion shqiptar i përbërë prej tij, Dervish Himës, Halil Pashës dhe shqiptarëve të tjerë katolikë e ortodoksë, duhej të nisej në drejtim të kryeqyteteve evropiane, për t'i dalë në mbrojtje çështjes kombëtare shqiptare⁷².

Me nismën e Ismail Qemalit e të Luigj Gurakuqit shqiptarët ndërmorën përpjekje të rëndësishme për mbajtjen e një kuvendi kombëtar si dhe për shpëtimin e trojeve shqiptare nga copëtimi. Ismail Qemali mendonte se rreziku më i madh për shqiptarët vinte nga sllavët. Prandaj, fillimisht ai u përpoq të bashkëpunonte me drejtuesit e shtetit grek. Sipas tij, Britania e Madhe ishte e vetmja fuqi, e cila për shkak të interesave të saj në Mesdhe do të përpiqej për të ndaluar zgjerimin sllav në Ballkan⁷³.

Pas arritjes së I. Qemalit dhe L. Gurakuqit në Bukuresht, kolonia shqiptare atje organizoi një mbledhje me shqiptarët e bashkësisë së madhe e të pasur të Bukureshtit më datë 5 nëntor 1912, në të cilën u trajtuan masat që duhej të merreshin në mbrojtje të ekzistencës së kombit

⁷¹ *Po aty*, Vj. 22-11-1136. Telegram i konsullit austro-hungarez Lejhanec, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 10 tetor 1912.

⁷² *Po aty*, Vj. 22-18-1852. Letër e Dervish Himës drejtuar A. Rappaport, konsull i Përgjithshëm i Austro-Hungarisë në MPJ në Vjenë, Kostandinopojë, 7 nëntor 1912.

⁷³ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912)*, vëll. V (gusht-nëntor), përgatitja dhe redaktimi nga akademik Beqir Meta, prof. dr. Muharrem Dezhgiu dhe prof. dr. Fatmira Musaj, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, dok. 307, f. 401-402. Letër nga një person anonim [Dervish Hima?], Pera, 21 tetor 1912; Dritan Egro, "Pse Ismail Qemali kërkoi autonomi dhe jo pavarësi nga Perandoria Osmane", në *Panorama*, Viti XIV, nr. 4708, f. 18-19.

shqiptar⁷⁴. Mbledhja e Bukureshtit mori disa vendime të cilat tashmë janë të njohura. Por, deklarata që doli nga kjo mbledhje nuk përcaktoi qartë nëse do të shpallej autonomia apo pavarësia e Shqipërisë. Heshtja për statusin e ardhshëm të vendit, me sa duket kushtëzohej nga dy faktorë të rëndësishëm. Në radhë të parë, nuk dihej reagimi i asaj pjese të popullsisë shqiptare, e cila mendonte se tokat shqiptare mbroheshin më mirë në kuadër të shtetit osman. Nga ana tjetër, ndërmarrja e hapit drejt pavarësisë ishte i kushtëzuar nga sigurimi i një mbështetje politike ndërkombëtare, e cila do të garantonte jetën e shtetit të sapolindur nga sulmet e fqinjëve⁷⁵.

Një grup nacionalistësh shqiptarë i përbërë nga Abdi, Fuad dhe Murat Bej Toptani, Bedri Pejani, Rexhep Mitrovica, Mid'hat Frashëri dhe Benoit Benusi arritën në Durrës me qëllim organizimin e një kuvendi kombëtar⁷⁶. Për koordinimin e veprimeve të parisë shqiptare për mbrojtjen e atdheut nga rreziku i copëtimit, Eqrem Bej Vlora vendosi të takohej në Durrës me bejlerët e familjes Toptani ndërsa Syrja Bej Vlora do të nisej në drejtim të Delvinës dhe të Gjirokastrës⁷⁷. Syrja dhe Eqrem Bej Vlora po përpiqeshin për mbajtjen e kuvendit kombëtar në ndonjë qytet shqiptar si në Vlorë, Tiranë, Krujë ose në Durrës⁷⁸. Musa Hamiti dhe Fehim Beu njoftonin se krerët nacionalistë të viseve jugore shqiptare po përpiqeshin me përfaqësuesit e qyteteve më të rëndësishme shqiptare, të hartonin një proklamata të përbashkët për ruajtjen e paprekshmërisë së territorit shqiptar⁷⁹. Për shkak të rrethimit të Shkodrës nga trupat malazeze, Syrja Bej Vlora nuk arriti në kohën e duhur në Vlorë, kjo vonoi mbajtjen e kuvendit të shqiptarëve⁸⁰.

⁷⁴ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-11-1146. Njoftim nga Bukureshti për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë, Vlorë, 6 nëntor 1912.

⁷⁵ Ismail Qemali, *Kujtime ...*, f. 349.

⁷⁶ *HHSStA.PA.A.* në *AIH*, Vj. 22-8-817. Telegram i nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, drejtuar një vapori të "Lloyd" dhe kryekonsullatës austro-hungareze në Shkodër, Durrës, 11 nëntor 1912.

⁷⁷ *Po aty*, Vj. 22-11-1136. Telegram i konsullit austro-hungarez Lejhanec, për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, Vlorë, 10 tetor 1912.

⁷⁸ *Po aty*, Vj. 22-8-825. Raport i konsullit austro-hungarez Lejhanec, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, kontit Berchtold, Vlorë, 13 nëntor 1912.

⁷⁹ *Po aty*, Vj. 22-8-811. Telegram i konsullit austro-hungarez Bilinski, drejtuar kontit Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme në Vjenë, Janinë, 7 nëntor 1912.

⁸⁰ *Po aty*, Vj. 22-8-809. Letër e konsullit austro-hungarez Lejhanec, për ministrin e Punëve të Jashtme në Vjenë, kontin Berchtold, tetor ose nëntor 1912.

Më 12 nëntor 1912, grupi i i nacionalistëve shqiptarë të Shqipërisë së Mesme u përpoqën të organizonin një kongres kombëtar në Durrës, por ndeshën në kundërshtimin e pjesës fanatike të popullsisë myslimane dhe ortodokse. Në këto kushte, nacionalistët shqiptarë hartuan një lutje drejtuar perandorit austro-hungarez Franz Jozefit I. Në emër të shqiptarëve të katër vilajeteve, ata kërkonin që të mos copëtoheshin trojet shqiptare dhe Shqipërisë t'i jepej autonomi e plotë nën Perandorinë Osmane. Nëse shteti osman nuk do të mbetej më në Ballkan, atëherë “Shqypnia prej katër vilajetesh me tre milion e sa shqiptarë, të bahet një Mbretëri në vehte sikurse të tjerat shtete të Ballkanve”⁸¹. Në mesin e atdhetarëve shqiptarë të mbledhur në Durrës u hodh ideja që kuvendi kombëtar të mbahej në Elbasan dhe u shpërndanë ftesat⁸².

Ismail Qemali së bashku me patriotë të tjerë shqiptarë u nisën për në Budapest dhe Vjenë me idenë se çështja shqiptare do të gjente mbështetje nga Austro-Hungaria. Në takimet e zhvilluara, ata shprehën pikëpamjen se shqiptarët ishin të vendosur për të mos lejuar copëtimin e vendit dhe se në rrethanat e krijuara, krijimi i shtetit të pavarur shqiptar ishte një zgjidhje e përshtatshme. Ministri i Jashtëm austro-hungarez, Berchtold, miratoi pikëpamjen e Ismail Qemalit për çështjen kombëtare shqiptare. Ai u shpreh se qeveria austro-hungareze dëshironte që Shqipëria të përfshinte brenda saj të gjithë shqiptarët⁸³. Me sa duket, nga ky takim Ismail Qemali siguroi mbështetjen e duhur për Shpalljen e Pavarësisë, kur deklaroi se “E ardhmja e Shqipërisë është siguruar...”. Kjo duket qartë edhe në intervistën që I. Qemali i dha gazetës “Piccolo” të Triestes më 20 nëntor 1912. Pyetjes se çfarë do të ndodhte pas arritjes së tij në Shqipëri, ai iu përgjigj prerë: “Shpallja e pavarësisë së atdheut tonë”⁸⁴.

⁸¹ *Po aty*, Vj. 22-6-697. Shtesë bashkëlidhur raportit të nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Vjenë, kontit Berchtold, Durrës, 13 nëntor 1912.

⁸² *Po aty*, Vj. 22-8-843. Njoftim i nënkonsullit austro-hungarez Rudnay, drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Durrës, 14 nëntor 1912.

⁸³ *Po aty*, Vj. 22-24-240; Vj. 22-8-818. Raport dite i përgatitur në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë mbi vizitën atje të Ismail Qemalit, Vjenë, 12 nëntor 1912.

⁸⁴ Ismail Qemali, *Kujtime ...*, f. 350.

*S u m m a r y*ASPECTS OF THE ATTITUDE TAKEN UP BY THE ALBANIANS DURING
THE FIRST BALKAN WAR

This article deals with the situation of the Albanians after the beginning of the First Balkan War which became worse after the Balkan armies marched into the inner Albanian territories. The Albanians were to face up to the big challenge of choosing between their religion and national identity. Most of them came to the conclusion that the biggest danger to them came from their neighbours rather than from the Ottoman state.

The cooperation of the Catholic Albanians with Montenegro must not be seen “en block”. There were two main trends prevailing among the Catholic Albanians: The first trend was mainly represented by Clergy leaders like Monsignor Jak Serreqi, Monsignor Bianki and Don Nikollë Kaçorri. They were convinced that the cooperation of the Albanians with Montenegro was fatal for the destiny of the Catholic Albanians. The second trend consisted of highlanders from Upper Scutari, a part of the Catholic inhabitants of the city of Scutari and any low rank clergymen which were armed and under the full influence of Montenegro.

The factors influencing some kind of confusion, demoralization and passivity of Albanians and of the Ottoman army in the Balkan War were: the Albanian national forces were not united among each-other in their way of thinking and doing, the armies of the Balkan League applied the tactic of “combat storm” in Albanian territories, the Balkan armies found some kind of support by a part of Albanians which were given weapons by the neighbouring governments, a great number of Albanians did not respond to the call for joining the Ottoman army.

The occupation of the greatest part of the Albanian territories by Serbian, Montenegrin and Greek armies during the First Balkan War in 1912 had unreparable consequences for the Albanian nation and the future of the Albanian state. For a number of reasons the passing of the Albanians from the platform of the administrative autonomy into that of the independence of Albania took place somewhere in the middle of November 1912 as it became obvious that the Ottoman army was broken in the Balkan War.